



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CN.nr.137/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Muhamet Rexha dhe Nenad Lazic, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit A.D. E., me seli në B.H., kundër debitorit N.P.T. A., me seli në V., me objekt kontesti borxh, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

A r s y e t i m i

Ish Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit A.D. E., me seli në B.H., ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit N.P.T. Arizona, me seli në V., për ekzekutimin e borxhit në lartësi prej 21.273 €.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin E.nr.297/11 të datës 29.05.2016, është shpallur jo kompetente për të vendosur në këtë çështje përmbarimore, ndërsa lënda i është dërguar Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, si gjykatë kompetente për të proceduar më tutje në këtë çështje juridike përmbarimore.

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, me aktvendimin CP.nr.157/2016 të datës 12.10.2023, në pikën I të dispozitivit është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridike përmbarimore të kreditorit A.D. E., me seli në B.H., kundër debitorit N.P.T. A., me seli në V., ndërsa në pikën II të dispozitivit është vendosur që pasi që ky

aktvendim të merr formë të prerë, lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1940/23 të datës 22.02.2024, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të hapë konflikt kompetence në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, për të vendosur në çështjen juridike përmbartimore në mes të kreditorit A.D. E., dhe debitorit N.P.T. A., Në pikën II të dispozitivit është vendosur që, për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-së dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr.08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori, A.D. E., me seli në B.H., më datë 03.06.2011 ka parashtruar propozim për përmbartim në ish Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori N.P.T. A., me seli në V., që t'ia paguaj shumën prej 21.273 €. Gjykata ka lejuar propozimin për përmbartim të paraqitur nga kreditori, ndërsa me aktvendimin E.nr.297/11 të datës 29.05.2016 është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, e pastaj kjo gjykatë lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës për vendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë çështje juridike me kompetencë lëndore për të gjykuar është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, për këto arsye:

Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbartuesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe.”* Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, përcaktohet se: *“Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”.* Me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së*

Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, dhe 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbare, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”.

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përmbare është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, për faktin se palët në këtë çështje përmbare kur është lejuar përmbare dhe lënda ka qenë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri nuk kanë ushtruar ndonjë mjet juridik kundër vendimit për lejimin e përmbarit, ndërsa kreditori nuk ka kërkuar që lënda të kaloj te përmbareuesi privat ashtu siç është përcaktuar me nenin 397 të LPP-së, andaj Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri mbi bazën e këtyre rrethanave nuk ka mundur të shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, por është dashur të vazhdoj në trajtimin e rastit.

Nëse ndonjëra nga palët do të paraqiste ndonjë mjet juridik në këtë çështje përmbare, ndërsa çështja është në kompetencë të Gjykatës Komerciale, kjo gjykatë do të kishte kompetencë lëndore që të vendosë për të gjitha mjetet juridike, ashtu siç është përcaktuar me LPP dhe nenin 13 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkesave të lëndës e bazuar në dispozitat e lartcekura, gjeti se gjykatë me kompetencë lëndore për të vendosur sipas propozimit për përmbare është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

CN.nr.137/2024, datë 21.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Zenel Leku